



VENDIMI ëSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKJE PRAVNO-SHËNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROŠEVAC

Dana

06 - 09 - 2017

P.nr.988/12

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me zyrtaren ligjore Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të akuzuarit, [REDACTED], për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par.1 nenpar. 4 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.689/12 të datës 08.08.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me datë 03.08.2017, ne praninë e prokurorit së Shtetit Valdet Avdiu dhe te akuzuarit shpall dhe publikisht komunikon këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, [REDACTED], nga [REDACTED] rr. [REDACTED], i lindur me [REDACTED], ne [REDACTED], nga i ti [REDACTED], e ema [REDACTED], e vajzërisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me profesion axhustator, i martuar, babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesëme, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me dt.27 prill 2012, rreth orës 20.00, në shtëpinë e tyre ne Ferizaj, i ka shkaktuar lëndim trupor të dëmtuarës- bashkëshortes [REDACTED], në atë mënyrë që i pandehuri me të shkuar në shtëpi kishte parë se e dëmtuara kishte përgatitur rrobat për tu larguar nga shtëpia për shkak të mosmarrëveshjeve që kishte pasur me të pandehurin dhe gjatë bisëdës së tyre i pandehuri kishte insistuar që e dëmtuara të mos largohet nga shtëpia dhe për një momenjt situata tensionohet dhe e godet me grushta në fytyrë me që rast i

shkakton lëndime të lehëta trupore, të cilat lëndime kanë shkaktuar dëmtim të përkohshëm të shëndetit të të dëmtuarës.

-me të cilën ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par.1 nenpar. 4 të KPK-së,

Ne bazë te dispozitës së lartshënuar dhe dispozitave nga neni 3,6,11,16, 34,38 39,64, 66 e 67 të KPK-së, si dhe neni 365 te KPPK-se të akuzuarin e,

GJ Y K O N

Me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3/tre/muaj i cili dënim konform nenit 38 par. 3 të KPK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 300 /treqind/ €, ekzekutimi i të cilit do të bëhet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimini me gjobë nuک mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 3 të KPK-së, në të kundërtën do ti zëvendësohet në dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 euro i pandehuri do të vuaj 1/një/ditë burgu.

E dëmtuara, [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED] për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor te paguaj shumën prej prej 30/tridhjet /€ në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Komunale në Ferizaj me propozim akuzen PP.nr.689/2012 të datës 08.08 2012 e ka ngarkuar të akuzuarin, [REDACTED] nga [REDACTED], për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga nen. 153 par.4 lidhur me par.1 nenpar.4 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj propozim akuze mbajti shqyrtimin fillestare me datë 03.08.2017 në të cilën përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit, i propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe ti shqiptohet dënim i paraparë me ligj. Gjyqtari pasi u bind se i akuzuari e ka kuptuar akuzën konform nenit 248 të KPPK-së, të pandehurit i ofroj mundësinë të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm, në të cilën shqyrtim i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, i premton gjykatës qe ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tillë apo te ngashme penale, i ka propozuar gjykatës qe ti shqiptoj një dënim sa me te butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq janë ekspertiza mjeko ligjore e dt.30.05.2012.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nerit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsy ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 153 par.4 lidhur me par.1 nenpar. 4 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 64,66 dhe 67 të KPK-sës duke bere zbutjen nen minimumin e parapar ligjor nga gjasht muaj burg ne tre muaj, si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer dhe nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, babë i dy fëmijëve, sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit fillestare, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përvç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënim i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënit të parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konformë nenit 458, 459 dhe 460 të KPPK-së, pasi qe nuk është specifikuar lartësia e dëmit nga ana e te dëmtuarës, gjykata të dëmtuarën Sevdije Isuf Bajrami, nga fshati Brod komuna e Shtërpcës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Konformë nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të paushallin gjyqësor te paguaj shumën prej 30/tridhjetë /€ në afat prej 30 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipërcekura është vendosur si në dispoë këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.988/12 me datë 03.08.2017

Zyrtarja Ligjore

Ganimete Avdiu

Gjyqtarja Individuale,

Hakile ILAZI



Këshilla juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosoves, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.